



E RËNDËSISHME PËR TU DITUR

Për të qëndruar në kopësht fëmija juaj duhet të jetë i shëndetshëm. Nëse fëmija juaj sëmuret në kopësht, do të kontaktoheni në tetelefon. Në rast së fëmija juaj ka sëmundje ngjitëse, duhet të njoftohet kopshti menjëherë.

Fëmija juaj do të kalojë kohë përjashtë, ju lutemi t'i jepini rroba të përshtatshme me vete.

Rroba të rehatshme, te cilat fëmija mund t'i veshë dhe t'i zhvesh vet janë me avantazh, sepse kështu fëmija mund të përkrahët në pavarësinë e tij.

Në kopsht festojmë festa si p.sh. ditëlindjet e fëmijëve. Disa nga festat

festohen bashkë me prindërit gjatë orarit ose jashtë orarit të kopshtit. Informacionet më të sakta do t'i merrni nga kopshti disa kohë përpara.

Në ditë të ndryshme organizohen ekskursione me grupet e fëmijëve të kopshtit. Lidhur me këtë do të informoheni në kohë ose do të ftoheni në takim tek ne.

Në rast se ju nuk e merrni vet fëmijën nga kopshti, duhet të informohet pedagogia me kohë. Duhet të sigurohet, që personi, që ngarkohet me këtë detyrë të jetë i përshtatshëm. Informacione të mëtejshme rreth kësaj merrni nga pedagogia.



INFORMACIONE TË MËTEJSHME

Kinderdrehscheibe“ ju informon ju në faqen www.kinderdrehscheibe.net në disa gjuhë për institucionet e arsimit dhe mbikëqyrjen e fëmijëve në të gjithë Steiermark-un si dhe për përkujdestarinë gjatë pushimeve dhe aktivitet gjatë kohës së lirë.

Impressum
Abteilung 6 Bildung und Gesellschaft
Referat Kinderbildung und -betreuung
Karmeliterplatz 2, 8010 Graz
Pädagogische Qualitätsentwicklung
Stempfergasse 1, 8010 Graz

Gëzohemi për kohën e përbashkët me fëmijën dhe familjen tuaj.

Fotos
gettyimages.at/FatCamera
A6 Bildung und Gesellschaft

Sprache
Albanisch



INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME
RRETH KOPSHTIT, PËRSHTATJES
DHE PLANIT DITOR

Mirë se vini në kopësht!



1

KOPSHTI – VENDI I FORMIMIT

Ne mirëpresim fëmijën dhe familjen tuaj tek ne në kopsht. Në faqet në vijim përshkruhet se çfarë bëjmë në kopsht, se si organizohet fillimi dhe se si ne dëshirojmë të bashkëpunojmë me ju dhe familjen tuaj.

Në Steiermark, vajzat dhe djemtë nga mosha tre vjeçe deri në fillimin e shkollës mund të frekuentojnë kopshtin. Kopshti është një vend i sigurtë, në të cilin fëmija juaj luan dhe duke luajtur mëson.

Pedagogët dhe kujdestarët e shoqërojnë fëmijën tuaj në zhvillimin e tij dhe bëhen persona të besueshëm për të.

Baza e edukimit në kopsht është „kuadri i arsimit mbirajonal“; informacione rreth çështjeve pedagogjike dhe rreth organizimit i gjeni në broshurën për konceptimin e kopshtit.

Kopshtet kanë për detyrë të mbështesin individualisht zhvillimin social, emocional, kognitiv dhe motorik të fëmijës tuaj. Ato kanë përgjegjësi të integritimit në lidhje me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore ose aspekte ndërkulturore dhe kontribuojnë në edukimin themelor fetar dhe etik. Kopshtet përgatisin vajzat dhe djemtë në një mënyrë gjithëpërfshirëse për hyrjen në shkollë.

Për ta njohur mirë fëmijën tuaj, për ne është i rëndësishëm bashkëpunimi me prindërit. Informojini pedagogët për dëshirat, shqetësimet si dhe për pasiguritë tuaja.

Zhvillimi i secilit fëmijë vëzhgohet dhe dokumentohet nga pedagogët. Një shkëmbim informacionesh se si ndihet fëmija juaj në kopsht dhe për çfarë interesohet ndodh në një bisedë për zhvillimin e tij, për të cilën do të ftoheni gjatë vitit. Megjithëse një bisedë e shkurtër për gjërat e rëndësishme mund të bëhet në çdo kohë.



2

FILLIMI I KOPSHTIT

Ju dhe fëmija juaj keni nevojë për kohë deri sa të mësoheni. Kjo mund të jetë shumë emocionuese për fëmijën tuaj. Njerëz të rinj, ambienti i ri, plane, rregulla etj. – të gjitha këto do të mësohen dalëngadalë bashkë me ju dhe fëmijën tuaj. Pedagogu/pedagogia ju informon se si të përshatëni më së miri.)

Merrni kohë dhe shoqërojeni fëmijën tuaj ditët e para. Qëndrimi në kopsht në fillim do të jetë i shkurtër. Duke marrë vesh me pedagogun/pedagogen e kopshtit, kohët do të zgjaten dalëngadalë.

Gradualisht pedagogët bëhen persona të besueshëm të cilët i japin siguri fëmijës suaj.

Nëse fëmija ndihet i sigurtë mjaftueshëm, atëherë duhet të vijojë përshëndetja e parë nga vetë fëmija. Ju do të prisni në një ambient tjetër dhe do të ktheheni përsëri pas disa minutash. Fëmija juaj me kalimin e kohës do të qëndrojë gjithnjë e më gjatë pa ju në ambientin e grupit. Gjatë kësaj kohe pedagogët dhe kujdestarët do të mbajnë kontakt intensiv me fëmijën tuaj, për të krijuar një marrëdhënie të mirë. Do të vijë momenti kur fëmija juaj do të rrijë pa ju në kopsht. Nëse fëmija juaj qan kur përshëndeteni me të, kthehuni ta ngushëlloni.

Përshatja mund të zgjasë disa javë. Një bashkëpunim i mirë me ju dhe punonjësit pedagogjikë është shumë i rëndësishëm.



3

PLANI DITOR NË KOPËSHT

Ju vini në mëngjes në kopsht me fëmijën tuaj dhe bashkë me të përshëndesni pedagogun/ pedagogen e kopshtit. Aty fillon përkujdestaria e pedagogëve dhe kujdestarëve. Më pas ju përshëndeteni me fëmijën tuaj.

Gjatë ditës fëmija juaj do të luajë vetëm ose me shokë, duke provuar gjëra të reja dhe kështu duke mësuar shumë gjëra. Ka oferta si p.sh. rrethi i mëngjesit, ushtrime të përbashkëta fizike, muzikë, shikimi i librave me vizatime. Fëmija juaj mbledh përvoja me materialet e ndryshme mësimore në fusha të ndryshme, si për shembull gjuha dhe komunikimi. Këto aktivitete bëhen brënda ose në oborr.



Paradite fëmijët hanë mëngjesin ose një gjë të vogël mes vaktesh. Disa fëmijë merren nga prindërit në orarin e drekës, të tjerët hanë një drekë të ngrohtë në kopsht dhe menjëherë më pas kanë mundësinë për të fjetur, për të pushuar, për të luajtur në oborr ose për të bërë aktivitete të ndryshme si paradite.

